

OLIVIER ROY

ISLAMI I GLOBALIZUAR

Përmbajtja

Parathënie	7
HYRJE. Lindja e një feje në Perëndim	9
Islami dhe ndryshimi i fushës fetare	12
Oksidentalizimi dhe dhuna.....	20
KREU 1. Ndërmjet nacionalizmit dhe parlamentarizmit: banalizimi i lëvizjeve islamiste	31
Nga islamizimi te nacionalizmi	31
Integrimi në lojën politike	38
Shekullarizimi shkon krahas me rikthimin e fetares.....	44
Riislamizimi konservator	48
Pasislamizimi	51
KREU 2. Myslimanët në perëndim.....	55
Si ta mendojmë islamin pakicë dhe pa shtet?	58
Akulturimi dhe rindërtimi identitar.....	64
Neoetniciteti.....	67
Nënkultura urbane dhe perëndimore e të rinjve të periferive.....	82
KREU 3. Individualizimi i fetarisë.....	82
Humbja e autoritetit fetar	83
Kriza e autoritetit dhe aktorët e ligjërit të ri fetar.....	90
Predikimi vë në shënjestër individin	103
KREU 4. Një islam humanist?.....	106
KREU 5. Oksidentalizimi: ndërmjet institucioneve të reja dhe frymës së kohës	118
Krijimi i “kishave” myslimane.....	118

Oksidentalizimi i pavetëdijshtëm	124
Neovëllazëritë	129
KREU 6. Neofondamentalizmi ose salafizmi	136
Burimet dhe aktorët bashkëkohorë	141
Neofondamentalizmi shkon krahas me globalizimin	147
1) Akulturimi	147
2) Nga individualizimi tek umma imagjinare:	
fundi i tokës së islamit	157
Hapësirat e islamizuara	160
Umma imagjinare dhe kufiri i saj i ri	166
KREU 7. Umma virtuale e Internetit.....	169
Shterritorializimi dhe komuniteti virtual.....	175
Individualizimi	181
KREU 8 Radikalët e rinj dhe xhahadi	189
1. Al-Kaeda	191
Matrica afgane: breznia e parë e Bin Ladenit ..	191
Brezi i dytë: internacionalistët islamikë të Perëndimit	196
Të rinjtë e ardhur nga imigrimi	198
Fendëruarrit	204
2. Hizb ut-tahrir	205
3. Radikalizimi islamik në Perëndim.....	207
Për ta përmbyllur: Përplasje qytetërimesh apo	
triumf i oksidentalizimit?	211
Kriza e strategjisë: po ku është armiku?	214
Demokratizimi i Lindjes së Mesme:	
strategji apo fantazmë?	217
Përplasje qytetërimesh apo luftë civile për vlerat?	219

Ky libër rreket të bëjë sintezën e ideve që kemi shtjelluar në vijim të veprës sonë *L'Échec de l'islam politique* (Dështimi i islamit politik). Ky titulli i fundit, që ne e kishim zgjedhur personalisht, natyrisht u bë shkak për polemika: si mund të flitet për dështim pas Bin Ladenit, ndërkohë që riislamizimi është në kulmin e vet, në kontekstin e rindërtimit identitar rreth fesë? Por, sipas nesh, këto dukuri janë pikërisht pasoja të dështimit për të ngritur një shtet islamik, dhe kanë të bëjnë me atë që e kemi quajtur neofondamentalizëm. Islamistët (revolucionari iranian, Refah-u turk, FIS-i algerian, Xhamiat-i islami pakistanez, Vëllezërit myslimanë, Turabi-të, në Sudan...) shohin tek islami një ideologji të mirëfilltë politike që mundëson ndërtimin e një shoqërie islamike, duke nisur nga shteti. Por koncepti i shtetit islamik është kundërthënës dhe i pamundur të realizohet sepse, nëse ka shtet, aty ka parësi të politikës, pra një formë shekullarizmi.

Sidoqoftë, kjo nuk i jep natyrisht fund kërkesës së islamit. Ajo çka shohim sot është shmangia në forma shumë të ndryshme, e çështjes së shtetit prej një lëvizjeje riislamizimi dhe rindërtimi identitar, e cila nisët nga individit dhe synon të rikrijojë një komunitet që nuk mund të mishërohet në një territor të dhënë, veçse në një formë virtuale. Kjo lëvizje e dyfishtë individualizimi dhe riterritorializimi është bash shenja e globalizimit të islamit, por sipas formash që mund të ndryshojnë shumë në shprehjen e tyre politike dhe fetare: islami spiritualist dhe humanist, neofondamentalizmi dhe komunitarizmi ose internacionalizmi radikal dhe militant.

Por, pavarësisht nga format në të cilën shfaqen, dhe në një logjikë të “dredhisë së historisë”, këto lëvizje janë të gjitha pjesë e globalizimit të islamit, pra edhe në oksidentalizimin e tij, sigurisht duke pranuar se gjatë këtij ndërveprimi dhe vetë shoqëritë perëndimore nga ana e vet, pësojnë ndryshime – një dukuri kjo që janë përpjekur ta arsyetojnë me termin (për mendimin tim të papërshtatshëm), të multikulturalizmit. Ky rikompozim shkon paralel kalimit të islamit në Perëndim. Por për ne nuk ka dy islama: ai i të ardhurave në Perëndim dhe ai i botës myslimane. Dhe në Perëndim kemi të bëjmë me të njëjtat dukuri, veçse në forma më të acaruara dhe mbi të gjitha të pakontrollueshme, si rezultat i mungesës së kontrollit shtetëror mbi fetaren. Ne e shohim islamin në Perëndim jo si një objekt në vetvete, në kuptimin sikur të kishte dy islama, por si një fill udhërrëfyes për të studiuar çka është, në fakt, një shterritorializim i islamit në përgjithësi. Sidoqoftë, më shumë se kurrë më parë, islami politik është një dështim: sfera politike po shkëputet nga ajo fetare dhe paralelisht me shekullarizimin politik, kemi të pranishme një rikthim të fetares në problematikën sociale. Por ky evoluim ka nevojë natyrisht, për disa shpjegime, që shpresojmë t'i ofrojmë në faqet që vijojnë.

Ndonëse disa prej analizave të përfshira këtu janë shtjelluar më parë në mjaft artikuj, ky libër në përgjithësi është i ri. Pjesa më e madhe e analizave i kam botuar në revistën *Esprit* që nga viti 1994 (dhe janë rimarrë në një libërth të titulluar *Vers un islam européen*¹); duhen shtuar aty dy artikuj të tjerë (“Le post-islamisme”² dhe “La communauté virtuelle: l’Internet et la déterritorialisation de l’islam”³). Së fundi, studimi ynë u bë i mundur falë mbështetjes së Institute for Transregional Studies, në Princeton.

Dreux-Princeton, maj 2002

¹. Botimet Esprit, 1999.

². *Revue des mondes musulmans et de la Méditerranée*, n° 85/86, Édisud, Aix-en-Provence, 1999.

³. *Réseaux*, CENT/Hermès Science Publication, Paris 2000.

Lindja e një feje në Perëndim

Islami ka kaluar përfundimisht në Perëndim. Jo në formën e një pushtimi, as të ndërrimit masiv të fesë, por nëpërmjet një zhvendosjeje vullnetare të popullsisë myslimane, e cila vjen në Perëndim për të kërkuar punë ose kushte më të mira jetese. Kjo gjendje në pakicë e islamit nuk është krejt e re, por sot ajo merr më shumë rëndësi, sepse globalizimi po përshkon dhe vetë hapësirën tradicionale myslimane. Në një kohë kur kufijtë mes qytetërimeve të mëdha po fshihen, shohim të shfaqen teori dhe lëvizje që synojnë pikërisht t'u rijapin jetë fantazmave të tyre: që nga "përplasja" te "dialogu" i qytetërimeve, duke kaluar nëpër komunitarizmin në të gjitha trajtat e tij, etnike ose fetare, duke vendosur kështu kufij të rinj, që s'kanë kurrfarë lidhje me një territor konkret. Ato nguliten në mendjet, sjelljet dhe ligjërimet. Dhe me t'u sajuar, për to nis lufta edhe me më shumë egërsi.

Në këtë kuptim, çështjet që po shtrojmë këtu nuk janë mirëfilli vetëm të islamit. Ato mund t'i formulonim kështu: rishpikja e një komuniteti fetar ideal, që bazohet vetëm mbi ushtrimin e besimit dhe përkushtimin vetjak, duke përjashtuar kështu traditat dhe kulturat specifike që lidhen me një vend apo hapësirë të caktuar gjeografike; krijimi i një fetarie që shihet si një mënyrë realizimi të vetes; pranimi tërësor dhe brutal i një jete që bazohet vetëm mbi praktikën fetare; perceptim i grupit të vet fetar si një pakicë e kërcënuar prej një mjedisi armiqësor (qoftë kur është fjala për fe të tjera, apo të mungesës së fesë); kërkesa ndaj shteteve të ndryshme për të njohur identitetin e një komuniteti fetar si të tillë, edhe kur ky përbën shumicën; kërkesa për ta gjetur kuptimin te një rikthim në bazat e Zbulesës, duke shmangur kështu filozofinë, kulturën dhe historinë; dhe, së fundi, parja e fetarisë vetjake dhe e besimit (atij të *born again*) si një e vërtete absolute, duke iu kundërvënë dijeve mondane. Të gjitha këto i gjen sot edhe te krishtërimi⁴. Objekti i këtij libri është pikërisht të studiojë transversalitetin e formave të evoluimit të islamit bashkëkohor: sesi, duke u nisur nga një Zbulesë dhe një histori vetjake, islami përshkohet prej prirjeve që i gjen dhe në fetë e tjera të mëdha? Është i njëjti transversalitet që shtrihet edhe në format e dhunës së radikalëve islamikë që janë më shumë shprehje e një kundërshtimi anti-imperialiste sesa e ndonjë tradite fetare.

"Riislamizimi" i mjedisit nuk është aspak vetëm një protestë identitare (siç thuhet kur bëhet fjalë për efektet që ka patur konflikti izraelo-palestinez në opinionin e myslimanëve të Francës), as ndonjë sintezë që bën të mundur të pajtohen së bashku besnikëria ndaj origjinës, moderniteti dhe autonomia individuale (siç dëshmohet në çështjen e perçes⁵). Ai është edhe pjesë përbërëse e një procesi akulturimi, domethënë zhdukje e kulturave të origjinës në dobi të një forme oksidentalizimi. Riislamizimi shoqëron këtë proces akulturimi, aq më tepër kur në të vërtetë, më shumë sesa një mënyrë reagim ndaj tij, ai ofron një mundësi për të jetuar e për t'u përshtatur me të. Riislamizimi është vetëdija se identiteti mysliman, deri këtu i konsideruar thjesht si vetvetiu i kuptueshëm, sepse ishte pjesë e një tërësie kulturore të trashëguar, nuk mund të mbijetojë po s'u riformulua shkoqur, jashtë çdo konteksti kulturor specifik, qoftë ky european ose lindor. Ai është i lidhur me vullnetin për të përcaktuar një islam universal, përtej kulturave specifike, brishtësia dhe karakteri historik i të cilave befas janë bërë të qarta.

Sigurisht, epoka e artë e qytetërimit arabo-mysliman mbetet e vlerësuar në të kundërt me periudhën koloniale: por kjo nostalgji supozon se ka pasur dekadencë. *What went wrong*⁶?, siç thotë titulli i një libri të

⁴. Shih punimet e Danièle Hervieu-Léger për ripërbërjen e krishtëritimit në Perëndim, në veçanti *La Religion pour mémoire*, Le Cerf, 1993.

⁵. Shih Farhad Khosrokhavar, *L'Islam des jeunes*, Flammarion, 1997.

⁶. Ku u gabua? Islami, Perëndimi dhe moderniteti, Tiranë, SHLK, 2004.

Bernard Lewis-it – Çka nuk eci? Përse “më e mira e feve është sot pasuri e popujve dikur masivisht të kolonizuar dhe sot rregullisht të poshtëruar, sa prej epërsisë ushtarake të kundërshtarëve të tyre (nga Palestina tek Iraku) aq edhe nga autoritarizmi dhe paaftësia e regjimeve të tyre politike? Përse islami është në Europë feja mbizotëruese në hapësirat ku ka përjashtim social? Ligjërimet nostalgjike, që sjellin ndërmend epokën e artë të islamit të kalifëve, nuk ofrojnë asnjë shpjegim, në mos atë të komplotit (kolonial apo sionist) aq më tepër që ky qytetërim klasik arabo-mysliman nuk është tamam një kulturë origjine, por një rindërtim pak mitik dhe ndonjëherë shkollor. Sot shohim pra një vullnet për të bërë tabula rasa dhe për këtë ligjërimi i fundamentalizmit përbën një instrument të shkëlqyer: ai refuzon të kaluarën, tejkalon ndarjet bashkëkohore dhe propozon një model universal që shkon në kahen e akulturimit të përgjithshëm të shoqërive aktuale.

Zhvendosja shpreh më shumë një kërkim të universales sesa nostalgjinë për një vend ose një shoqëri që sidoqoftë, nuk janë modele pozitive (si Algjeria ose Pakistani sot), nga të cilët largohen për të gjetur një jetë më të mirë në Europë ose në Amerikë. Si t’i lidhësh së bashku mërinë ndaj Amerikës dhe radhët përpara konsullatave amerikane për të marrë një vizë? Ky kërkim universaliteti bëhet kundër kulturës së origjinës, por edhe kundër “kulturës perëndimore”, që përpiqen ta sjellin edhe atë në një rast historik specifik. Kritika ndaj mëtimeve të qytetërimit europian të Iluminizmit se është universal (sidomos për përkufizimin e të drejtave të njeriut) është diçka që e gjen shpesh tek intelektualët e sotëm myslimanë, siç gjen dhe distancimin ndaj kulturave specifike të historisë arabo-myslimane, që nuk duan t’i ngatërrojnë me mesazhin kuranik⁴. Islami në Europë jepet njëherësh si “i pamishëruar” në pikëpamje kulturore dhe sociale, domethënë që nuk pranon të jetë një fe “etnike” dhe shprehje e një kulture të importuar, çka do të ishte në kundërtënie me mesazhin e tij të universalitetit. Myslimanët ushtrues të fesë nuk duan të përcaktohen si arabë, turq apo pakistanezë, por si myslimanë duke iu shmangur me këtë edhe diferencimit social dhe ekonomik, që njëherësh i ndan ndërmjet tyre dhe i veçon nga pjesa tjetër e shoqërisë. Por, duke e bërë këtë, ata shtrojnë nga ana e vet pyetjen e thekët që i ka munduar antropologët dhe historianët perëndimorë: a ka një thelb të islamit përtej mishërimeve të tij kulturore?